



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:078642

Datë: 27.05.2019

Numri i dokumentit: 00328984

PKR. nr. 18/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti për Krime të Rënda - sipas Kryetarit të trupit gjykues Gëzim Pozhegu, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. Sh. nga fshati K., Komuna e Istogut, për veprën penale Falsifikimi i parasë të parashikuar nga neni 302 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të rënda, PP/I.nr.20/2019 datë 27.03.2019, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Ali Uka dhe të akuzuarit, me datë **20.05.2019**, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **27.05.2019**, përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. Sh.**, i biri i F. dhe nenës A., e gjinisë B., data e lindjes . . . në Pejë, tani me banim në fshatin K., Komuna e Istogut, me nr. personal . . ., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

Është Fajtor

Për shkak se:

Me datë 01.01.2019 duke qenë në dijeni se paraja është e falsifikuar, në Gjakovë në Rr.” . . .”, pikërisht në pompën e karburanteve . . .ka vënë në qarkullim një kartëmonedhë prej 100 euro (njëqind euro) me numrin serik . . ., në atë mënyrë që natën kritike rreth orës 20:45 min, i pandehuri F.me automjetin e markës “. . .P” me tabela të regjistrimit . . .ngjyrë të bardhë shkon tek pompa për furnizuar me derivate për shumën 5 euro duke ia ofruar të dëmtuarit punëtorit S. L. kartëmonedhën prej 100 euro ashtu që i dëmtuari ia kthen kusurin prej 95 euro, dhe në ndërkohë i dëmtuari dyshon se ajo kartëmonedhë se është e falsifikuar menjëherë lajmëron policinë, ashtu që në bazë të ekzaminimit të kësaj kartëmonedhe nga ana e Agjensionit të

Kosovës për Forenzikë nr. . . . të datës 11.02.2019 është konstatuar që e njëjta rezulton falsifikim i plotë.

-me çka ka kryer veprë penale : Falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK-së.

Andaj **Gjykata** me aplikimin e neneve **3, 6, 17, 21, 38, 48, par. 1 dhe 2, nenit 62, par.2, nënpar. 2.7., neni 69, par.1 dhe 2, nenit 70, nenit 302 par.2 dhe 6** të KPRK-së si dhe neneve **359 par.2, 366, 450**, të KPPK-së, të akuzuarin e

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ NJË (1) VITI

kështu që në bazë të nenit 48 par. 1 dhe 2 të KPRK-së

I shqiptohet

DËNIM ME KUSHT

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, që iu është shqiptuar të akuzuarit F. Sh., nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy (2) viteve nuk kryen veprë të re penale.

Në kuptim të nenit 450 par.4 të KPPK-së, i akuzuari obligohet që të që të paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej njëzetepesë (25) €, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetepesë (25) € si dhe shumë prej pesëdhjetë (50) € në emër të kompensimit të viktimave të krimit, konform neni 39 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 302 par.6 lidhur me nenin 62, par.1 dhe 2, nënpar.2.6 të KPRK-së, i konfiskohet bankënota prej 100 euro (njëqind euro) me numrin serik . . . , e cila pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të asgjësohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.20/2019 datë 27.03.2019, kundër të akuzuarit F. Sh. nga fshati K., Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari i lartcekur, e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit iu është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë.

Me këtë rast, gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPPK, kështu që i akuzuari F. Sh., ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshme për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe shtonë se këto deklarime

paraqiten si shprehje e vullnetit të lirë, pasi ai është kryes i kësaj veprë penale, prandaj e pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem sipas aktakuzës.

Dhe se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është mbështetur në provat: në raportin e Stacionit Policor – Njësi i Hetimeve Gjakovë të oficerit policor G. Y.me nr. 2019-EA-0002 datës 01.01.2019, raporti i oficerit policor E. K.numër 2018:OP-021 datë 09.01.2019, dëftesa e kartëmonedhës së konfiskuar datë 01.01.2019, raporti i hetuesit M. A.numër 2019-EA-0002, ekspertiza e kartëmonedhës nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë . . . datës 11.02.2019, bankënota e falsifikuar me nr.serik . . . , si dhe provat tjera të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të akuzuarit F. Sh. për pranimin e fajësisë, gjyqtari kërkon që mendimin e vet për këtë ta japi prokurori i shtetit.

Prokurori i Shtetit, në këtë drejtim deklaroi se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, i njëjti fajësinë e ka pranuar edhe gjatë deklarimit në Prokurori, me qenë se një pranim i tillë është bërë në baza vullnetare dhe ka mbështetje në provat në bazë të cilave është ngritur aktakuza, i ka propozuar gjykatës që të pranoj një pranim të tillë të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Në vijim, gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit vlerësoi së pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të akuzuarit, pasi ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë pas konsultimeve të nevojshme në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, konform nenit 246 të KPPK-së.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 të KPPK-së si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 246 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave e as fjala përfundimtare.

Me faktet e ofruar si dhe pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit pa dyshim rrjedh se në veprimet e të akuzuarit F. Sh. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale : Falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin F. Sh. gjykata ka vlerësuar se i njëjti është i moshës së re, është penduar për veprimin e kryer, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërit veprë të tillë si dhe nuk do bie ndesh me ligjin, sjelljen korrekte të pandehurit pas kryerjes së veprës penale si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si rrethanë tjetër e posaçërisht lehtësuese gjykata e merr faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale, e duke i vlerësuar këto rrethana si posaçërisht lehtësuese konform nenit 69, 71 dhe 72 të KPRK-së të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Gjikata për të akuzuarin nuk ka gjet asnjë nga rrethanat rënduese.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 69 par.1 të KPK-së, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë.

Gjykata po ashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do t'iu shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, dhe ky dënim do të ketë efekt preventivë gjeneral për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par 1 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes se këtij aktgjykimi gjyqtari i udhëzoi palët me të drejtë ankese, se mund ta parashtrajnë përputhje me nenin 368 par.1 të KPPK-se.

**GJYKATA THEMELORE – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë,
PKR.nr. 18/19, datë 27.05.2019**

Procesmbajtësja,

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,

Zyrtarja Ligjore
Arbënore Basha

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.